



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA

KA.nr.305/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Administrative, gjyqtarja Vlora Pacolli Rexhepi, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit “Seti Commerc” sh.p.k., me Nr. te Biznesit 810633116, me seli ne Shiroke, Komuna e Suharekës e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga L.B. avokat, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, me kërkesëpadi për anulim të Vendimit të Komisionit te Ankesave të Komunës së Suharekës me numër Ref. 01-N-332-23536, të datës 26.06.2020, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesorë më datë 06.03.2024, me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditur, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, më datë 22.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

- I. **REFUZOHET** në tërësi kërkesëpadija e paditësit “Seti Commerc” sh.p.k., me Nr. te Biznesit 810633116, me seli ne Shiroke, Komuna e Suharekës, kundër të paditurës Komuna e Suharekës, me çka ka kërkuar anulimin e Vendimit të Komisionit te Ankesave të Komunës së Suharekës me numër Ref. 01-N-332-23536, të datës 26.06.2020, **si e bazuar**
- II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Historiku procedural

- 1) Më datë 08.07.2020, në Gjykatën Themelore Prishtinë, Departamenti për Çështje Administrative, paditësi “Seti Commerc” sh.p.k., me seli ne Shiroke, Komuna e Suharekës e cila sipas autorizimit përfaqësohet nga L.B. avokat, ka parashtruar padi

kundër të paditurës Komuna e Suharekës, me kërkesëpadi për anulim të Vendimit të Komisionit të Ankesave të Komunës së Suharekës me numër Ref. 01-N-332-23536, të datës 26.06.2020, me propozim që çështja të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i paditur me rekomandim që oferta e paditësit duhet të shqyrtohet me kujdes, se nuk ka baze për eliminimin e paditësit nga gara dhe se fituesi i kësaj procedure duhet të shpallet në përputhje të plote me dispozitat në fuqi. Lënda është evidentuar me nr. A-1149/2020.

- 2) Pas funksionalizimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës sipas Ligjit Nr. 08L-015 për Gjykatën Komerciale, lënda është bartur në këtë Gjykatë dhe evidentohet me shifrën KA 305/22.
- 3) Më datë 06.03.2024, gjykata caktoi dhe mbajti seancë të shqyrtimit kryesor publik me pjesëmarrje të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditur Afrim Bytyqi avokat komunal, në mungesë të përfaqësuesit të autorizuar të palës paditëse, ftesën për seancë e ka pranuar me datë 22.02.2024, ndërsa në ditën e mbajtjes së seancës me datë 06.03.2024 e njofton gjykatën se nuk mund të përfaqësojë në seancë sepse është i angazhuar në një rast tjetër – provat nuk i ka bashkangjitur, dhe ka propozuar shtyrje të seancës. Përfaqësuesi i të paditurës parashtresën e ka dorëzuar me vonesë dhe nuk ka bashkangjitur prova, prandaj konform nenit 41 të LKA-së, u mbajt seancë në ungesë të përfaqësuesit të autorizuar të paditurës. Propozimi i përfaqësuesit të paditurës për tu konsideruar e tërhequr padia u refuzuar si i pabazuar në ligj konform neni 21 par.2 të LKA-së, dhe në mungesë të përfaqësuesit të paditësit u lexua padia.

Pretendimet e paditësit

- 4) Përfaqësuesi i paditësit në padi ka deklaruar se, me 12.02.2020 Komuna e Suharekës ka shpallur Konkursim të Hapur nr. 01/2020 për dhenien në shfrytëzim afatgjatë prej 15 deri 99 vite të pronës së paluajtshme komunale, gjegjësisht parcelës Nr. 2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m², sipas planit rregullativ "depo ndërtimore". Me 26.02.2020 paditësi ka paraqitur aplikacionin e tij në konkursin e shpallur dhe këtij aplikacioni i ka bashkëngjitur të gjitha dokumentet të cilat janë kërkuar me konkurs.

- 5) Me 26.02.2020 Komisioni per Hapjen e Ofertave ka bere hapjen e ofertave dhe ka konstatuar se pala paditëse i ka paraqitur te gjitha dokumentet te cilat kane qene te specifikuara me konkurs. Me këtë rast komisioni për hapjen e ofertave ka përpiluar procesverbal dhe ka konstatuar se paditësi se bashku me aplikacionin ka parashtruar te gjitha dokumentet e nevojshme.
- 6) Me 20.05.2020 pala e paditur, permes Komisionit per zbatimin e procedurave të dhenies ne shfrytezim te prones se paluajtshme te Komunës, ka nxjerre njoftimin 01-Nr-016-18104, me te cilin njoftim paditësi njoftohet se nuk është shpallur fitues ne konkurrimin Nr.01/2020, të datës 12.02.2020, me arsyetimin se paditësi "diskualifikohet ne mungese te dokumentit "Planit te Investimit", edhe përkundër faktit se Komisioni për Hapjen e Ofertave kishte konstatuar se paditësi i kishte parashtruar te gjitha dokumentet e nevojshme për vlerësim te ofertës si edhe përkundër faktit se pala paditëse kishte paraqitur plan te detajuar investues.Me 26.05.2020 paditësi paraqet ankese tek organi administrativ i shkallës se dyte, gjegjësisht te Komisioni i Ankesave ne kuadër të Komunës së Suharekës, të cilës ia ka bashkëngjitur edhe deklaratën e projektuesit, gjegjësisht kompanisë NSH "Smart Architecture", te përgatitur nga V.E., inxhinier i diplomuar në arkitekturë, ku ne mënyre specifike ceket se projekti ideor ishte ne harmoni te plote me PRRU ZI Shiroke dhe me dispozitat ligjore ne fuqi si dhe deklarone ne mënyre shprehimore se plani investiv kap vlerën prej 1,721,037.90 Euro.
- 7) Me 01.06.2020 Komisioni i Ankesave i Komunës se Suharekës me Vendimin Ref. 01-Nr-615-18547/2020 e aprovon ankesën e paditësit si te bazuar dhe e kthen tërë procesin e konkurrimit ne rishqyrtim dhe rivlerësim te ofertave, me arsyetimin se sipas komisionit te vlerësimit nuk ishte e qarte nëse plani investim duhej te paraqitej si dokument i veçante apo mund të paraqitej se bashku me planin ideor. Me 11.06.2020 Komisioni për Zbatimin e procedurave te dhënies ne shfrytëzim te pronës se paluajtshme te Komunës nxjerr njoftimin 01-Nr.-104-22338 me te cilin e njofton paditësin se nuk është shpallur fitues me arsyetimin e njëjte se nuk kishte paraqitur planin investiv. Ndaj këtij vendimi me 16.06.2020 paditësi paraqet përsëri ankese. Komisioni i Ankesave te Komunës së Suharekës, me 26.06.2020 sjelle vendimin Ref. 01-Nr-332-23536 me te cilin e refuzon ankesën e paditësit si te pabazuar, me arsyetim se vendimi i organit administrativ te shkalles se pare është i drejtë për shkakun se paditësi nuk e ka prezantuar planin investiv.

- 8) Përfaqësuesi i paditësit konsideron se me akti administrativ të goditur me padi, ashtu siç parashihet me paragrafin 3 te Nenit 16 te Ligjit 03/L-202 për Konfliktet Administrativ, nuk ishte vërtetuar drejte gjendja faktike dhe nga faktet e vërtetuara është nxjerrë përfundim (konkluzion) jo i drejte ne pikëpamje te gjendjes faktike, se paditësi ka paraqitur Planin Ideor Pjese e te cilit ka qene dhe Plani Investiv, në shumë prej 1,721,037.90 Euro.
- 9) Prandaj konsideron se janë plotësuar kushtet e parapara me paragrafin 1.3 të Nenit 16 te LKA-se, dhe duke qenë se është kështu, atëherë akti administrativ i goditur me padi duhet te anulohet dhe çështja duhet te kthehet ne rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i paditur me rekomandim që oferta e paditësit duhet te shqyrtohet me kujdes, se nuk ka baze për eliminimin e paditësit nga gara dhe se fituesi i kësaj procedure duhet te shpallet ne përputhje te plote me dispozitat ne fuqi.

Kundërshtimet e të paditurës

- 10) E paditura e paditura Komuna e Suharekes në përgjigje në padi, te cilin e përfaqëson Av. Publik i Komunës dhe në fjalë përfundimtare ka propozuar që të refuzohet ne tersi si e pabazuar padia, kërkesëpadia e palës paditëse NNT "Seti Commerc" sh.p.k. nga Suhareka dhe të mbetet ne fuqi Vendimi 01 Nr.332-23536 i dt. 26.06.2020 i Komisionit për Ankesa, me arsyetime se kërkesëpadia është e pa baze dhe e cila nuk ishte e mbeshtetur ne prova konkrete materiale dhe as mbi bazën ligjore per arsyet pas vlerësimit të ofertave në ankand publik, sipas shpalljes për konkurrim te hapur nr. 01/2020 te dates 12.02.2020 është vlersëuar se paditësi nuk plotëson te gjitha kriteret e kërkuara ne këtë konkurrim. Në gjykatë ka paraqitur planin e njërës nga kompanitë fituese dhe ka sqaruar se plani investiv ne vete përbën detajet e përshkrimit të përgjithshëm dhe të veçantë të strategjisë, misionit, qëllimit, strukturës organizative, personelit planit financiar e shumë të tjera, ndërsa paditësi në ofertën e tij pretendon se paramasa dhe parallogaria mund të merret si plan investiv, gjë që kjo nuk qëndron prandaj, gjykatës andaj, i propozoj gjykatës që padinë dhe kërkesëpadinë ta refuzoj si të pabazuar e po ashtu të njëjtës pasi pala paditëse ka pranuar me kohë ftesën për seancë të shqyrtimit kryesor, dhe mungesën e tij nuk e ka arsyetuar kërkojmë nga gjykata që konform dispozitave ligjore të konsideroj që padia dhe kërkesëpadia është tërhequr.

Provat e administruara

11) Gjykata me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së vendimit kontestues dhe vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike, në seancën e shqyrtimit kryesor ka administruar këto prova: Shpallja për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020, aplikacioni i paditësit “Seti Commerc” SH.P.K i datës 26.02.2020 të bashkangjitura dokumentacioni i regjistrimit të biznesit, deklaratat e tatimit në prove, vërtetim tatimor, deklaram i të ardhurave të korporatave, dokumentacioni i dorëzuar për NNTSH “Drini Company” SH.P.K, Marrëveshje e grupit të OE “Seti Commerc” dhe NNTSH “Drini Company” Shpk, Plani dinamik, lista e numrit të punësuarve, Paramasa dhe paralogaria, Procesverbali i hapjes së ofertave me datë 26.02.2020, Ankesë nga paditësi “Seti Commerc” SH.P.K kundër njoftimit të AK me datë 26.05.2020, Vendim i komisionit të ankesave me nr. Ref 01.Nr.61518547/2020, Njoftim nga Komuna e Suharekës në procedurë të rivlerësimit me datë 11.06.2020 me të cilën rekomandohet si fitues OE “Graniti & Euro Besi”, Ankesë kundër këtij njoftimi e dorëzuar nga paditësi për AK me datë 16.06.2020, Vendim i komisionit të ankesave me nr. Ref:01.Nr.332-23536/2020 me datë 26.06.2020, provat e administruara u krahasuan me dosjen origjinale të OE “Seti Commerc” SH.P.K të dorëzuar në procedurë të konkurrimit dhe plani investiv i OE “Graniti “ SH.P.K. dhe “Euro Besi” SH.P.K i dorëzuar në këtë aktivitet të ankandit.

Vlerësimi i gjykatës

12) Gjykata vlerësoi ligjshmërinë e vendimit kontestues në përputhje me nenin 44 të LKA-së dhe në përputhje me nenin 8 të LPK-së vlerësoj provat e administruara në seancën e shqyrtimit kryesor në raport me pretendimet e paditësit në padi, përgjigjen e të paditurës në padi, deklaramet në seancë si dhe pas shqyrtimit gjeti se kërkesëpadija e paditësit është e pabazuar.

13) Gjykata, shqyrtoi ligjshmërinë e vendimit të goditur me padi në kuptim të nenit 9 të Ligjit për Konfliktet Administrative i cili përcakton se: “Gjykata në konfliktin administrativ vendos për ligjshmërinë e akteve përfundimtare administrative, me të cilat organet e administratës, në ushtrimin e autorizimeve publike, vendosin për të

drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të personave fizikë dhe juridikë në çështjet administrative.”

14) Nga provat e administruara gjykata vlerësoj këtë gjendje faktike: sipas shpalljes për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020 kriteret e kërkuara janë: Deklarata vjetore tatimore nga ATK-ja për 2(dy) vitet e fundit, Vlera e investimeve konform deklaratave vetore për dy vitet e fundit - do te vlerësohet për objekt 15% te pikëve, ndërsa për pajisje 5% te pikëve, Çmimi për metër katror te parcelës, minimumi 0.05 cent/ m2 ne vit, Numri i te punësuarve, specifiko pozitat e deklaruara te punëtoreve - numri i punëtoreve duhet te jete ne harmoni me vlerën e investimeve, Lloji i veprimtarisë adekuate, Personat fizik dhe juridik qe nuk posedojnë prone në shfrytëzim ne ZI- Shiroke vlerësohet me 5% të pikëve, Plani dinamik - jo më shume se dy vite...15% te pikëve, Projekti ideor konform Planit Rregullues te Hollësishëm Zona Industriale-Shiroke si dhe planit investiv me 10% të pikëve.

15) Në aplikacion të paditësit “Seti Commerc” SH.P.K të datës 26.02.2020 janë të bashkangjitura: dokumentacioni i regjistrimit të biznesit, deklaratat e tatimit në prove, vërtetim tatimor, deklaram i të ardhurave të korporatave, dokumentacioni i dorëzuar për NNTSH “Drini Company” SH.P.K, Marrëveshje e grupit të OE “Seti Commerc” dhe NNTSH “Drini Company” Shpk, Plani dinamik , lista e numrit të punësuarve, Paramasa dhe paralogaria.

16) Në Plani dinamik nga OE “Seti Commerc” dhe “Drini Company” Shpk me titull Nr. 2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m2, sipas planit rregullativ "depo ndërtimore", në pasuri shoqërore Komuna Suharekë, janë përcaktuar aktivitetet punuese dhe afati për kryerje të punimeve për tre muaj.

17) Ndërsa në Paramasa dhe Paralogaria (blerja dhe makineri) nga OE “Seti Commerc” dhe “Drini Company” Shpk me titull Nr. 2785/25 me sipërfaqe prej 8000 m2, sipas planit rregullativ "depo ndërtimore", në pasuri shoqërore Komuna Suharekë, janë përcaktuar blerjet për makineri, njësia, sasia, çmimi, shuma totale në vlerë prej 5,779,600.00 €.

18) Nga Procesverbali i hapjes së ofertave me datë 26.02.2020 janë vlerësuar paraqitja e dëshmimeve të kërkuara, e jo të kriterëve të kërkuara. Kriteret e kërkuara janë plotësuar nga raporti i Komisionit për vlerësimin e ofertave të datës 20.05.2020, me të cilin paditësi është eliminuar për shkak të mungesës së planit rregullativ. Kundër vendimit për eliminim paditësi ka parashtruar ankesë me 01.06.2020, Komisioni i Ankesave i Komunës së Suharekës me Vendimin Ref. 01-Nr-615-18547/2020 e ka aprovuar ankesën e paditësit si të bazuar dhe e ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivlerësim të ofertave që tq sqarohet nëse plani investim duhej të paraqitej si dokument i veçantë apo mund të paraqitej së bashku me planin ideor. Me 11.06.2020 Komisioni për Zbatimin e procedurave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës e njofton paditësin se nuk është shpallur fitues me arsyetimin e njëjtte se nuk kishte paraqitur planin investiv. Ndaj këtij vendimi me 16.06.2020 paditësi paraqet përsëri ankesë. Komisioni i Ankesave të Komunës së Suharekës, me 26.06.2020 sjelle vendimin Ref. 01-Nr-332-23536 me të cilin e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, me arsyetim se vendimi i organit administrativ të shkallës së parë është i drejtë sepse paditësi nuk e ka prezantuar planin investiv.

19) Gjykata vlerëson se sipas shpalljes për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020 janë kërkuar Plani dinamik - jo më shumë se dy vite...15% të pikëve dhe Projekti ideor konform Planit Rregullues të Hollësishtëm Zona Industriale-Shiroke si dhe planin investiv me 10% të pikëve, dërsa paditësi ka dorëzuar Plani dinamik ku janë përcaktuar aktivitetet punuese dhe afati për kryerje të punimeve për tre muaj, nga dosja origjinale konstatohet se paditësi ka dorëzuar Planin Ideor, dhe ka dorëzuar Paramasë dhe Paralogaria paditësi i ka përcaktuar punët përgatitore, punët e betonit, punët e muratimit dhe suvatimit, punët e konstruksionit metalik, punët e dyshemesë, punët e partneritetit dhe punëve të ndryshme të detajuara njësisia, sasia, çmimi, shuma totale në vlerë prej 1,721,037.90 €. Gjykata vlerëson se Paramasa dhe paralogaria e dorëzuar nga paditësi nuk përmban të gjitha elementet që plani investiv do të duhej të përmbajnë, përveç objektivave-përcaktimit të punëve dhe shumës së investimit nuk përmban, planin financiar, investimet kapitale dhe shpenzimet operative, rreziqet e investimit, etj.

20) Prandaj gjykata vlerëson se vendimin i kundërshtuar me nr. Ref. 01-Nr-332-23536 i datës, 26.06.2020 i nxjerrë nga Komisioni i Ankesave të Komunës së Suharekës, me

te cilin e refuzon ankesën e paditësit si të pabazuar, me arsyetim se vendimi i organit administrativ të shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, për shkakun se paditësi nuk e ka prezantuar planin investiv, e që ka qenë kërkesë specifike e shpalljes për konkurrim të hapur e datës 12.02.2020 ku theksohet se kriteret e kërkuara përveç tjerash janë Projekti ideor konform Planit Rregullues të Hollësishëm Zona Industriale-Shiroke si dhe planit investiv me i vlerësuar me 10% të pikëve. Po ashtu gjykata vlerëson se vendimi i kundërshtuar është në përputhje me nenin Neni 47 të LPPA-së, sa i përket strukturës dhe i përmban të gjitha elementet e detyrueshme të aktit administrativ të shkruar si dhe arsyetimin konform nenit 48 të LPPA-së.

21) Prandaj duke qenë se nga provat e administruara nuk u vërtetuan pretendimet e paditësit, bazuar në nenet 13, par. 1, nën par. 1.12 lidhur me par. 5 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale dhe nenin 46 paragrafi 2 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi. Lidhur shpenzimet procedurale gjykata vendosi në bazë të nenit 63 të LKA-së.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Administrative

KA.nr.305/22, datë 22.03.2024

Gjyqtarja

Vlora Pacolli Rexhepi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita e pranimit të aktgjykimit, në Dhomën e Shkallës së Dytë në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.